



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.437/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, në Raundin e Dytë të Zgjedhjet Lokale, për Kryetar Komune për që janë mbajtur më datë 09.11.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.437/2025, e datës 11.11.2025, parashtuar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, në Raundin e Dytë të Zgjedhjet Lokale, për Kryetar Komune që janë mbajtur më datë 09.11.2025.

A r s y e t i m

Me datë 11.11.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën thekson më datë 09.11.2025 në fshatin Doganaj të Komunës së Kaçanikut, në shkollën fillore "Ali Asllani" - vendvotimi nr. 0709, janë vërejtur persona të paautorizuar që kanë hyrë dhe kanë qëndruar në hapësirat e vendvotimit pothuajse gjatë gjithë ditës, pa pasur ndonjë rol apo autorizim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Personat e përfshirë ishin Suad Koxha, Blerim Koxha (asambleist) dhe Naser Murseli.

Më tej në ankesë theksohet se prania e tyre përbën formë presioni ndaj votuesve dhe cenim të parimit të votimit të lirë dhe të fshehtë, duke ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Kjo bie ndesh me nenin 82 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe me nenin 3 dhe 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit, të cilat përcaktojnë se në hapësirat e vendvotimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët e Këshillit të Vendvotimit, vëzhguesit e akredituar dhe votuesit me të drejtë vote, ndërsa personat e tjerë

lejohen vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe me autorizim të posaçëm. Veprimet në fjalë cenojnë qartësisht integritetin e procesit zgjedhor dhe krijojnë perceptim të presionit politik ndaj qytetarëve të fshatit Doganajt. Kjo situatë është e verifikueshme përmes kamerave të sigurisë të vendosura në objektin e shkollës "Ali Asllani" dhe dëshmive të komisionarëve e vëzhguesve të pranishëm. Andaj kërkojnë nga PZAP që të hetojë rastin e parregullsive në vendvotimin 0709, Sh.F,M.U "Ali Asllani", Doganaj, Komuna e Kaçanikut, të verifikojë përmes kamerave të sigurisë praninë e personave të paaautorizuar të përmendur më sipër; dhe të marrë masat ligjore ndaj shkelësve dhe të rekomandojë veprimet e duhura për ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor.

Në përgjigje në ankesë KQZ sqaron se bazuar në nenin 82 paragrafi 3 i Ligji Nr. 08/17228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenin 3 paragrafi 4 dhe nenin 6 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcaktohet procedura dhe personal e autorizuar në QV dhe nëVV. Gjithashtu, ju njoftojmë se në dhomën operative të KQZ-së, më datën 9 nëntor 2025, nuk është raportuar rasti në fjalë. KQZ, gjithashtu, pas pranimi të kërkesës nga PZAP, ka kontaktuar Zyrtarin Ekzekutiv të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Kaçanikut, i cili ka njoftuar si në vijim: Komisioni Komunal i Zgjedhjeve gjatë ditës së zgjedhjeve të datës nuk ka pranuar asnjë ankesë nga kjo qendër e votimit nga personat përgjegjësi menaxheri i qendrës së votimi anëtare të Këshillit të vendvotimeve apo edhe vëzhguesit e kësaj qendre përkatësisht vendvotimeve. Gjithashtu ne nuk kemi pranuar asnjë ankese nga asnjë subjekt politik përfshirë edhe Lëvizjen Vetëvendosje apo për ndonjë parregullsi në qendrën e votimit 0709 në fshatin Doganaj. Më tej në përgjigje theksohet se KQZ-vazhdimisht ka qenë në komunikim me Policinë e Kosovës përkatësisht stacionin policor në Kaçanik ku çdo qendër e votimit është përcjellë nga dy polic permanent dhe si pjesë e kësaj as nga këta nuk ka ndonjë informacion se ka pasur persona të paaautorizuar brenda kësaj qendre të votimit apo për ndonjë parregullsi në ndonjë qendër të votimit në komunën e Kaçanikut.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij. KQZ, njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) të komunës së Kaçanikut, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pabazuar.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore të ankuesit subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, lidhur me atë se disa persona të paaautorizuar kanë qëndruar në hapësirat e vendvotimit pothuajse gjatë gjithë ditës duke ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, Paneli i

vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, janë të pabazuara për faktin se e njëjti nuk ka arritur që të vërtetoj, përkatësisht të dëshmoj faktin se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e saj, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë të vetme dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e saj se disa persona të paautorizuar kanë qëndruar në hapësirat e vendvotimit pothuajse gjatë gjithë ditës duke ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Kurse pretendimet e theksuara më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se *“PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës, nuk mund të vërtetohet se persona të paautorizuar kanë qëndruar në hapësirat e vendvotimit pothuajse gjatë gjithë ditës duke ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Po ashtu, Paneli ka vlerësuar se lidhur me këtë pretendim nuk ka pasur asnjë vërejtje apo ankesë në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, i cili nuk ka pranuar asnjë ankesë nga kjo qendër e votimit nga personat përgjegjësi menaxheri i qendrës së votimi anëtare të Këshillit të vendvotimeve apo edhe vëzhguesit e kësaj qendre përkatësisht vendvotimeve.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Kështu që Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, konstatoi se dëshmitë e ofruara nuk janë të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se pretendimi i parashtrueses se ankesës se disa persona të paautorizuar kanë qëndruar në hapësirat e vendvotimit pothuajse gjatë gjithë ditës duke ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, e të cilëve i referohet pala ankuese, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, andaj në rrethanat e rastit konkret ankesa është refuzuar si e pa bazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.437/2025, datë 12.11.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.